

# LETROT E LEXUESVE:

Tungjatjeta Shefki!

Gazeta është një mrekulli! Të lumtë!  
Uroj suksese! E kam një vërejtje. Pseudointelektualët e Kosovës nuk mund vlerësojnë jetën politike të Fadil Hoxhës, sepse ata nuk kanë njohuri sesi janë zhvilluar ngjarjet. Ne nuk duhet që ta ndihmojmë propagandën e Millosheviqit për antigjakovarizëm!

Të fala vëllazërorë: Fatmir Shyti.

Tungjatjeta Zotëri Shefki Oseku

Norvegji, 01. Maj 1996.

Të falenderoj shumë për revistën Drita që më kishte dërguar. Revista më pëlqeu shumë. I riuthe dhe suksese në të ardhmen!  
Të them të drejtën u kënaqa kur e pashë se kishit marrë këtë listë aq të rëndësishme dhe të vështirë. Në situatën e tanishme në të cilën gjendemi dhe që nuk ka nevojë ta komentojmë, puna e gazetarit kërkon aftësi dhe zgjuarësi të madhe. Sigurisht shumë gazetarë që dëshirojnë të ndikojnë në njëfarë mënyre në opinionin, ndodhen para një dileme të madhe sa i përket mënyrës së rrabjes së problemeve të ndryshme. Ta zgjedhim mënyrën kritike apo lavdëruese? Nuk e di se cil është më e "përshtatshme" për ne, në situatën e tanishme. Po, e VËRTEJTA është ajo për të cilën duhet shkruar, pavarësisht nga reagimet...

Partia, problemi i veçantë është edhe ajo sesi shkruhet të jenë gjithmonë të freskëta. Gazetari amerikan John B. Bogart për risinë thotë: "nëse një qen e kafshon njeriun, nuk është kurrfarë risie. Por, nëse një njeri e kafshon qenin, ajo është risi".

Një ditë e pyeta një vëllazëri po i shkron puna me gazetën "e tij" e ai m'u përgjigj: Neq, po më shajmë, dikush po më thotë je me filanin e dikush je me flitëkun, më kanë lodhur. Sa për ta qortësuar i thash se për kritikën Volteri ka thënë: "më shumë vlejné 12 vargje të Homerit ose të Virgjilit se të gjitha kritikët që janë shkruar për këta njerëz të mëdhenj". E, Volteri i "shkretë" këtu e ka thënë për kritikët e vet, kurse tek ne është fjala për tjerë "kritikë".

Në kushtet tona është pothuajse e pamundur që të mos shkruash për politikë. Dmth, duhet të bëhesh përfundimisht politikë. E past që edhe unë këtu e ceka politikën, tani m'u kujtua shënja: "Politika është adozhita i vetmi profesion prej të cilit nuk kërkohet një shkollë e veçantë". E, mua po më duket se këtu kushtet tona, në Kosovë, kanë nxjerrë në sipërfaqe shumë "politikanë". Nuk po di a ("i quaj "politikan" apo "krimkë" sepse, disa njerëz vetëm kritikojnë pa ditur se cka kritikojnë?!

Pra, derha të them, se sot është shumë vështirë të punohet në fushën gazetareske. E, unë Ju uroj të gjithë atyre që punojnë në atë drejtim e që tani më shumë se kurrë kemi nevojë për "Inform".

Sipas mendimit tim disa gazeta po shkuajnë paksa tepër për të kaluarën e shumë pak për këtë realitet që po na preokupon sot. Është koha që të axierim mësim nga e kaluara por mos të merremi veç me

të kaluarën e ta harrojmë të sotmen e cila është vendimtare për të ardhmen.

Angazhimi dhe aktiviteti i Shqiptarit Tënd më duket mahnisës! Nuk po gjej fjalë për lavdata! Ju lumte baba Shefki dhe, suksese në punën Tuaj, e cila na nevojitet në këtë kohë të vështirë...

Ju përsënder për zemërsisht nga Norvegjia!  
Izet Shatri

## TUNGJATJETA BABA SHEFKI!

Të falenderoj shumë që më ke dërguar të dy numrat e revistës "DRITA". Unë, i kam lexuar, diçka edhe kam fotokopjuar dhe po t'i kthej që të dy numrat mbirapa, sipas kërkesës sate.  
Përfundim nga rasti t'ju dërgoj edhe urimet e mia më të mira për daljen e revistës suaj. Suksese në miratimin tuaj fixim në shërbim të kombit tonë!  
TË FALENDERIT SHUMË!

10.05.96

Me nderime:

NEXHAT SADIKU

Malmö

Norvegji

REDAKSIA:  
I FALENDEROJME TË GJITHË ATA QË NA KANË SHKRUAR!

Revistë kulturore - informative  
Kultur - och informationstidskrift

Shoqata BESA, në Trelleborg, Suedi  
Föreningen BESA i Trelleborg, Sverige

# DRITA

Viti I  
Nr. 3/96  
Çmimi  
30 :-



RAMADAN SHALA, VETERANI I LËVIZJES SONË  
KOMBËTARE: MES FAMILJES SIME E SERBISË - ISHIN VARRET...

...Si çdo redaksie, edhe neve na ka ardhur një letër anonime dhe një poezi në stilin popullor.

BILBILI ME VORFRI

BILBIL O BILBILI I NJER.

SI TËZU RRUGA MË TËRR.

JAM BILBIL MË KRAH TË THYR.

MËKA ZËR ZELA VORFRI,

HU MËZU VORFRI E SHKRET.

SMUJ MËZOR TËRRAT MËJ HJEK.

SMË QILLOJ KËMË ESAKIC.

TË QELI BRUGEN TË DAL MË DRIT.

TË QELI BRUGEN TË DAL MË DRIT.

SI MËQEL KËT RUG TË NJER.

SI TËJETOJ MËT TËRR TË SHKRET.

PSE BILBIL MË ETA KRAH TË THYR.

VON UZGJOVA I QELA SYT.

KUR UZGJOVA IQELA SYT.

IPASH TËRRAT ISHIN RRI.

O BILBIL BILBILI NJER.

ADOT KISH MAJHER NAJ SHPRES.

PËR MËKNO MË NAJ PRANVER.

KUTUM VIN DËZ VILËZRIT TËJER.

DOT KHOJN ZBASËKU MË NJI DËZ.

SE PA VILËZER NUK DOT KA JET.

MË NI LUL ZDOT KËT PRANVER.

PËRGJIGJE:

Patëm fesa, besa edhe gosti  
Zani yt bilbil s'tu ndi?  
(Pse je n'therrë - unë s'po m'ërzitem  
Dikush terrin e - dikush driten!)  
Vet s'e di, po disa m'kanë thanë  
Trepërqindëshin ti s'je tue dhanë  
NË t' shkollë gjatë, o bilbil i shkretë  
Emni yt do të del në gazetë.  
Veç një gja e kam me të ndime:  
Trimni t'vret para - i ligu pas shpine!